

## Si të përmirësojmë të nxënit për të rritur për personat me aftësi të kufizuara

**Bashkohuni me komunitetin e EPALE me më shumë se 27 000 specialistë të të nxënit për të rritur për të vlerësuar, komentuar dhe kontribuar!**

Të dashur kolegë të EPALE,



Tema e EPALE për muajin qershor ishte **Nxënësit e Rritur me Aftësi të Kufizuara**. Ne u fokusuar në rolin e të nxënit për të rriturit për të integruar personat me aftësi të kufizuara dhe për t'ju siguruar atyre mundësi të barabarta përsa i përket zhvillimit personal dhe profesional. Gjatë kësaj kohe ekipet kombëtare dhe komuniteti i EPALE kanë publikuar një numër me raste studimore frymëzuese, artikuj, raporte dhe burime të tjera. Ju mund t'i gjeni ato në faqen tonë të posaçme **Nxënësit me aftësi të kufizuara**.

Me datë 8 qershor EPALE i ftoi të gjithë që të ndanin pikëpamjet e tyre në lidhje me mënyrën e përmirësimit të të nxënit për të rriturit për personat me aftësi të kufizuara. Diskutimi i ndezur u moderua nga Koordinatorja Tematike e EPALE **Gina Ebner** dhe mori 130 komente nga pjesëmarrës nga 15 vende të ndryshme.

**Lexoni përmbledhjen e përgatitur nga Gina në lidhje me diskutimin në EPALE** (në gjuhën angleze, greke dhe estoneze).

## Postime në formë blogu

**Lehtësimi i aksesit tek arsimit për të rriturit me aftësi intelektuale të kufizuara - përse funksionojnë modelet tërësisht gjithëpërfshirëse** (në gjuhën angleze dhe frënge).

Josephine Finn, Saranne Magennis dhe Laura Burke nga Universiteti Maynooth (UM) në Irlandë reflektojnë në lidhje me Nismën e të Nxënësve Gjithëpërfshirës në UM dhe mësimet e saj të gjera përsa i përket arsimit për të rriturit.

**Nga kullojëset që rrjedhin e deri tek kodet e detyrueshme: Çfarë mbrojtje kanë nxënësit me aftësi të kufizuara në Angli?** (në gjuhën angleze)

Jo Honigmann, Drejtor Ekzekutiv i [CPotential](#) (linku është i jashtëm), foli për mënyrën sesi nxënësit me aftësi të kufizuara në Angli mbrohen nga ligji.

**Arsimi Favorizues: Një qasje arsimore ndaj rehabilitimit të të rriturve** (në gjuhën angleze dhe frënge).

Dr. Melanie R Brown, Drejtore e Institutit Kombëtar për Arsimin Favorizues shpjegon se çfarë nënkupton arsimi favorizues dhe mënyrën sesi mund të përfitojnë nga ai të rriturit me çrregullime motorike neurologjike

## Lajme nga mbarë Europa



Muaji qershor ishte një muaj i ngjeshur me aktivitete për sektorin e të nxënit për të rriturit në mbarë Europën:

- Në Finlandë Bordi i Edukimit **miratoi disa kritere të reja për kurrikulat e arsimit bazë për të rriturit** (në gjuhën finlandeze).
- Ndërkohë në Estoni **Grupi i Nivelit të Lartë për Arsmin dhe Formimin u takuan në Tallinn** për të diskutuar në lidhje me aspektet pozitive të bashkëpunimit të sektorëve të arsimit në BE dhe me fushat që kanë nevojë për përmirësim (në gjuhën angleze dhe estoneze).
- **Polonia organizoi Kongresin e saj të tretë Kombëtar për Andragogjinë** ku specialistë dhe teoricienë nga mbarë vendi diskutuan në lidhje me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me të nxënit për të rriturit (në gjuhën polake).

### **Bashkohuni tani!**

Mos harroni të regjistroheni në EPALË për të qenë në gjendje që të ndani mendimet tuaja në këto postime. [Bashkohuni tani](#) dhe bëhuni pjesë e komunitetit të përbërë nga më shumë se 27 000 specialistë të të nxënit për të rriturit.